



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 8 datë 21.07.2022

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në pallatin e kulturës
“Labëria “ (Ora 10¹²)

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1.Ramona Jaho | 20.Elona Toçaj |
| 2.Jonela Halili | 21.Frosina Qyrdeti |
| 3.Bujar Osmanaj | 22.Sokol Kushta |
| 4.Ina Islamaj | 23.Ervis Moçka |
| 5.Grigor Dede | 24.Alboren Aliaj |
| 6.Liljana Breshani | 25.Kristaq Meçi |
| 7.Mujo Shakaj | 26.Evis Allushi |
| 8.Fatos Rukaj | 27.Jerina Dervishaj |
| 9.Arben Meksi | 28.Klara Bajaziti |
| 10.Adiola Gjoka | 29.Istref Dobi |
| 11.Ardian Skëndaj | 30.Brunilda Cani |
| 12.Rozina Kormuzi | 31.Anxhela Aliraj |
| 13.Edlira Kapllanaj | 32.Lindrit Beqiraj |
| 14.Anisa Shametaj | 33.Englantina Imeraj |
| 15.Sulltana Bilbilaj | 34.Teki Xhemalaj |
| 16.Gentian Hamzaraj | 35.Andi Resulaj |
| 17.Pëllumb Nezha | 36.Asime Feraj |
| 18.Edison Kapaj | 37.Roneda Muçaj |
| 19.Simo Petromilo | 38.Brunilda Saliaj |

Mungojnë :

- 1.Ervis Caushaj
- 2.Migena Balla
- 3.Klearda Rapushi
- 4.Julian Bleta
- 5.Briseida Çakërri
- 6.Sulejmën Bubeqi
- 7.Rudi Pashaj
- 8.Kasëm Mahmuti
- 9.Kreshnik Tepelena
- 10.Paula Sullaj
- 11.Besian Gega



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 8/1 datë 21.07.2022

Znj.Jonela Halili – Përshëndetje! Po fillojmë mbledhjen jashtë radhe, me kërkesën e bërë nga 23 këshilltarë me rendin e ditës të miratuar nga kryesia e këshillit bashkiak .

Pika 1 e rendit të ditës, është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë , datë 1 korrik 2022. Por, më parë kalojmë në miratimin e rendit të ditës . Votohet .

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro , të gjithë – 38 vota.

Miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës . Jeni njohur , e kemi marrë dhe me e-mail.

E kalojmë në votim. Votohet.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Pro – 38 vota.

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 8/2 datë 21.07.2022

Znj.Jonela Halili – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit
“ Për lidhjen e marrëveshjes specifike me MIE për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë ”.

Z.Ardian Skëndaj – Është informacion nga MIE.

-Uji, pa të ardhurat ÷ 77% ;

- ÷ 33 milion euro ,detyrim ndaj shtetit ;

- Mbulim kosto ÷ 29,2% ;

-Humbja vjetore ShAU ÷75 milionë e 206 lekë/reja. Bilanci totalisht negativ.

Ujësjetës - kanalizime, i ka të gjitha llogaritë bankare të bllokuara. Nuk mbulon shpenzimet e veta. Është material zyrtar nga MIE. Nëqoftëse e doni, ju'a jap.

Znj.Jonela Halili – Ka ndonjë pyetje, diskutim ?

Z.Ardian Skëndaj – E hedhim në votim.

Znj.Jonela Halili – Nga administrata ?

Znj.Aulona Veizi /Zv.Kryetare e bashkisë - Në emër të kryetarit të bashkisë ka një relacion.

Kryetari i bashkisë është njohur me shkresën e ardhur nga këshilli për mbledhjen jashtë radhe dhe me pikën 2 të rendit të ditës. (Lexon projekt vendimin).

Në mbledhjen e datës 26.05.2022 , është futur një projekt vendim nga këshilltarët që, është propozuar dhe votuar . Për këtë s'ka asnjë projekt vendim dhe relacion në lidhje me këtë çështje. Në datën 26 maj , këshilli ka marrë vendim në lidhje me këtë çështje , por për shkaqe objektive , nuk është dërguar në prefekturë , për shprehje ligjshmërie.

Pra, është mungesa e një formati në letër dhe për shkaqe objektive nuk ka shkuar në prefekturë.

Projekt vendimi i paraqitur nga këshilltarët dhe vendimmarrja me çdo kusht në lidhje me VKM Nr 302 datë 11.05.2022, konstatohet si një vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore .

Në pikën 6 , citon...cënohet pjesëmarrja e publikut. Mungon transparenca me qytetarët për këtë problem shumë jetik, siç është uji i pijshëm.

-VKM , thuhet... me nisjen e negociatave .., por nuk tregon , përcakton, cilat njësi .

-Marrëveshja hyn në fuqi...(lexon) Marrëveshja merr formë, kur nënshkruhet nga palët.

VKM i referohet vullnetit të qeverisjes vendore por , nuk shihet në asnjë pikë, detyrimi .

Ligji Nr 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore “, bashkia ka funksionimin, transmetimin, furnizimin, prodhimin ... Cili organ e mënjanon bashkinë nga përgjegjësia...

-Një çështje serioze e anashkaluar , është dëgjesa me publikun.

Në nenin 54 (lexon)..këshilli i bashkisë , para miratimit të akteve, zhvillon séance këshillimi me bashkinë.

-Në pikën 11, ligji 139/2015subjekt , është bordi apo shoqëri tregëtare...me qëllim kryerjen e një shërbimi.

Në pikat 1 dhe 2.

-Prodhimi, furnizimi me ujë ..

- Largimi dhe trajtimi i ujrave të ndotura ...Në analizë të dy pikave të mësipërme,ka të bëjë me një nga funksionet e qeverisjes vendore , ku ligji përcakton se është përgjegjës pushteti vendor . Pra, nga njëra anë kërkohet të ngrihet një organ i ri dhe nga ana tjetër kemi Ujësjellës Kanalizime.

Nga sa më lartë, projekt vendimi , është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në kundërshtim me VKM nr 302. Kërkojmë nga ana juaj , mos të miratohet ky projekt vendim. Të bëhen dëgjesat publike dhe bashkëpunim me bashkitë e tjera.

Z.Ardian Skëndaj – Dëgjova, por nuk pashë asgjë nga këto që thashë më lartë.

÷ 33 miljonë euro, detyrim ndaj shtetit, mbulim kosto....etj . Nuk dëgjova nga këto nga fjala e zonjës nënkryetare.

Z.Ervis Moçka – Dëgjova nënkryetaren e bashkisë , mbajta disa shënime, shumë nga pretendimet bien. E diskutuam dhe në komisionin juridik dhe do të doja që juristët të sillnin një relacion. Kryetari thotë për marrëveshjen që s’ekziston . Ne po miratojmë autorizimin. Të negociohet, pra, të shtohet tek pika 1 ..Të autorizohet negocimin me 2 apo më shumë njësi të qeverisjes vendore dhe lidhjen e marrëveshjes.....

Me këtë propozim dhe me këtë amendim , të ulen në tavolinë.

-U pretendua se, është i jashtëligjshëm. VKM Nr 302 e ka parashikuar qartë , është shoqëri tregëtare me 2 nivele. Pra, bie ky pretendim.

-Përsa i përket negocimit, bazë është ligji nr 139/2015 ..Neni 7, neni 54, i përcakton qartë për këshillin bashkiak . Administrata do të paraqesë gjithë shqetësimet, do të vijë në këshill. Funkcioni kryesor, neni 33,... funksioni, mënyrat si kryhen këto funksione.Është e vërtetë , është funksion i Bashkisë Vlorë, por neni 33 e thotë qartë dhe , ky pretendim , bie. Pra, administrata, të ulet të negociojë me MIE, me bashkitë fqinjë. Ky projekt vendim, autorizon ekzekutivin të negociojë . Është autorizim.

Znj.Jonela Halili – Po lexoj amendimet që u thanë dje në komisionin juridik .Lexon kreun, bazën ligjore të projekt vendimitVendosi :

Pika 1, Të autorizojë negocimin dhe lidhjen

Pika 2 ,...ngarkohet dhe drejtoria e menaxhimit financiar.

Pika 3,. ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr 139/2015 .

Atëherë, kalojmë në votim . Votohet.

Kundër – 1 votë .(z.Andi Resulaj)

Abstenim – 0 vota.

Pro – 37 vota.

Miratohet.

Atëherë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur .

Faleminderit.

Mbajti Procesverbalin

Zhaneta Gjika

V.O: Bashkëlidhur , kopje e relacionit të kryetarit të bashkisë .